

Foumi Shqiptar Social Ekonomik - ASET

Ftesë për Ofertë për shërbime përkthimi të Guidës Turistike

Forumi Shqiptar Social Ekonomik-ASET është një OJF e themeluar në vitin 1999. Në kuadër të Projektit Promovimi dhe ruajtja e vlerave kulturore, historike dhe artistike në Bashkinë Patos, ASET **kërkon të kontraktojë shërbim përkthimi të specializuar në gjuhën Italiane** Ky projekt mbështetet nga ReLOaD2, i cili financohet nga BE dhe zbatohet nga UNDP.

Kushtet për pjesëmarrje:

Të gjithë individët ose subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë ofertën e tyre sikurse parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese deri më 29 Korrik 2022, në adresën e e-mailit: info@aset-al.com ose në adresën postare: Forumi Shqiptar Social Ekonomik, Rr. Dibrës, P 487 Sh 2, Tiranë.

Individi/subjekti që ofron shërbimin me çmimin më të ulët dhe në përputhje me specifikimet teknike sipas ftesës, do të njoftohet për të nënshkruar kontratën.

Datat specifike të dorëzimit të materialit të përkthyer do të përcaktohen në kontratën e lidhur me individin/subjektin fitues.

I. KUSHTET PËR SUBJEKTE OFERTUESE

Specifikimet teknike:

Për këtë projekt, ASET do të zhvillojë procedurën e prokurimit për shërbimin sipas pershkrimit në tabelën e mëposhtme.

Nr	Përshkrimi i mallit/ shërbimit/	Çmimi/njësi Me TVSH nga subjekte të licensuar
1	Përkthim guide turistike shqip/Italisht, 3000 fjalë përfshirë edhe numrat.	

Specifikime të Përgjithshme Teknike

- Subjekti duhet ta përkthejë materialin me saktësi dhe me kujdesin e duhur.
- Shërbimi i përkthimit duhet realizuar për një periudhë një javore nga data e dërgimit të materialit për përkthim.



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 – ReLOaD2, financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

Foumi Shqiptar Social Ekonomik - ASET

Kushtet e Përgjithshme

1. Subjekti duhet të jetë i regjistruar dhe licensuar rregullisht me objekt veprimtarie shërbimet e kërkuara.
2. Të kenë eksperiencë të mëparshme në fushën e përkthimit në gjuhën italiane, për të cilën ofron shërbimin e përkthimit.
3. Kanë përparësi subjekte të regjistruar me aktivitet në territorin e bashkisë Patos ose zona përreth.
4. Kanë përparësi Subjektet që kanë mbi 3 vite eksperiencë në përkthim në gjuhën italiane për të cilën aplikojnë të ofrojnë përkthim.
5. Kanë përparësi Subjektet që kanë eksperiencë të mëparshme në përkthimin mbi turizimin/gjeografinë e fusha të ngjashme.
6. **DOKUMENTACIONI DUHET DËRGUAR ELEKTRONIKISHT NË ADRESEN INFO@ASET-AL.COM, BRENDË DATËS 29 KORRIK 2022, ORA 16.30 OSE NË ADRESËN POSTARE: FORUMI SHQIPTAR SOCIAL EKONOMIK, RR. DIBRËS, P 487 SH 2, TIRANË NUK PRANOHEN OFERTAT DORAZI.**
7. Pagesa e subjektit kryhet me transfertë bankare pas marrjes së shërbimit dhe lëshimit të faturës përkatëse.

Për çdo informacion shtesë na shkruani në info@aset-al.com ose në adresën postare: Forumi Shqiptar Social Ekonomik, Rr. Dibrës, P 487 Sh 2, Tiranë jo më vonë se data 25 Korrik 2022.

Dokumentacioni i kërkuar:

1. CV në gjuhën Shqipe ose gjuhën italiane që do të ofrojë shërbimin subjekti i regjistruar;
2. Fotokopje e diplomes/diplomave të studimit e përfaqësuesit të subjektit që do të ofrojë përkthimin e materialit nga shqipja në italisht;
3. Dokumenta të tjera që dëshmojnë eksperiencat e mëparshme në fushën e përkthimit.
4. Ofertë financiare të plotësuar, e cila duhet të jetë në ALL (TVSH të përfshihet në kosto/çmim), dhe të dhënat e plota të personit të kontaktit.
5. Subjekti i regjistruar dhe licensuar, subjekti duhet të paraqesë Licencën për ushtrimin e aktivitetit / Ekstraktin e QKB të marre deri një ditë para postimit të ofertës;
6. Numrin e llogarisë bankare.



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 – ReLOaD2, financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

Foumi Shqiptar Social Ekonomik - ASET

II. KUSHTET PËR INDIVIDË OFERTUES

Specifikimet teknike:

Për këtë projekt, ASET do të zhvillojë procedurën e prokurimit për shërbimin sipas pershkrimit në tabelën e mëposhtme.

Nr	Përshkrimi i mallit/ shërbimit/	Çmimi/njësi Çmimi nga individë
1	Përkthim guide turistike shqip/italisht, 3000 fjalë përfshirë edhe numrat.	

Specifikime të Përgjithshme Teknike

- Përkthyesi duhet ta përkthejë materialin me saktësi dhe me kujdesin e duhur.
- Shërbimi i përkthimit duhet realizuar për një periudhë një javore nga data e dërgimit të materialit për përkthim.

Kushtet e Përgjithshme

1. Individët të ketë përfunduar arsimin e lartë (minimalisht) nivel Master në gjuhën italiane.
2. Të kenë eksperiencë të mëparshme në fushën e përkthimit në gjuhën italisht , për të cilën ofron shërbimin e përkthimit.
3. Kanë përparësi kandidatët që banojnë në Patos ose zona përreth.
4. Kanë përparësi kandidatët që kanë mbi 3 vite eksperiencë në përkthim në gjuhën italiane për të cilën aplikojnë të ofrojnë përkthim.
5. Kanë përparësi kandidatët që kanë eksperiencë të mëparshme në përkthimin mbi turizimin/gjeografinë e fusha të ngjashme.
6. **DOKUMENTACIONI DUHET DËRGUAR ELEKTRONIKISHT NË ADRESEN INFO@ASET-AL.COM , BRENDË DATËS 29 KORRIK 2022, ORA 16.30 OSE NË ADRESËN POSTARE: FORUMI SHQIPTAR SOCIAL EKONOMIK, RR. DIBRËS, P 487 SH 2, TIRANË NUK PRANOHEN OFERTAT DORAZI.**
7. Paga kryhet me transfertë bankare pas marrjes së shërbimit.



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 – ReLOaD2, financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

Foumi Shqiptar Social Ekonomik - ASET

Për cdo informacion shtesë na shkruani në info@aset-al.com ose në adresën postare: Forumi Shqiptar Social Ekonomik, Rr. Dibrës, P 487 Sh 2, Tiranë jo më vonë se data 25 Korrik 2022.

Dokumentacioni i kërkuar:

1. CV në gjuhën Shqipe ose gjuhën italiane e Individit që do të ofrojë shërbimin;
2. Fotokopje e diplomes/diplomave të studimit e individit që do të ofrojë përkthimin e materialit nga shqipja në italisht;
3. Dokumenta të tjera që dëshmojnë eksperiencat e mëparshme në fushën e përkthimit.
4. Ofertën financiare në ALL, ku duhet të paraqesin të dhënat e plota të personit te kontaktit. Në ofertë duhet përfshirë në vlerë dhe tatimi në burim i cili do të zbritet nga cmimi total për tu paguar nga ASET.
5. Numrin e llogarisë bankare.



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 – ReLOaD2, financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).